



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 321/3 Prot.

Tiranë, më 27.07.2016

**V E N D I M**

**Nr.95, datë 27.07.2016**

**“Për përfundimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Ministria e Integrimit Evropian”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, referuar nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë “Mbi verifikimin e ekzekutimit të vendimit nr. 78, datë 29.07.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Integrimit Evropian”,

**Vërej se:**

Në zbatim të Vendimit nr. 16, datë 10.03.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Integrimit Evropian”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është realizuar mbikëqyrja në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.78, datë 29.07.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Integrimit Evropian”, në të cilin është vendosur:

1. Të miratojë raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Ministria e Integrimit Evropian, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të

punësimin, për nëpunësit dhe punonjësit, të cilët u gjendën në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, sipas kërkesave të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.

3. Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, të formalizojë procesin e hartimit të përshkrimit të punës, nëpërmjet,
  - një raport me shkrim mbi fillimin, ecurinë dhe përfundimin e procesit nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore;
  - të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin e miratuar, së bashku me opinionet përkatëse, lidhur me bashkëpunimin e realizuar me njësinë e burimeve njerëzore; dhe pas kësaj,
  - të realizojë miratimin e përshkrimeve të punës, nënshkrimin e tyre dhe dokumentimin, duke i depozituar më pas pranë Departamentit të Administratës Publike.
4. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në përmbushje të detyrimeve ligjore, si dhe të rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në përmbajtjen e raportit, duhet të marrë masat për të bërë të mundur verifikimin e përmbajtjes dhe procedurës së ndjekur për hartimin e formularit të përshkrimit të punës, dokumentimin e këtij procesi dhe më tej, për të administruar këtë formular, në materialet përkatëse, të cilat ruhen pranë arkivës së tij.
5. Njësia e burimeve njerëzore, duhet të përfundojë procesin e konfirmimit për nëpunësit, të cilëve i ka përfunduar periudha e provës, duke vepruar në këtë mënyrë :
  - Të përfundojë procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
  - Momenti i vlerësimit të punës duhet të llogaritet duke filluar nga data e daljes së aktit të emërimit të nëpunësit civil, për rastet kur nëpunësi ka filluar punë nëpërmjet procedurave të konkurimit, sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*” dhe në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, ende nuk ishte përmbushur periudha e provës (1 vit).
  - Momenti i vlerësimit të punës, për punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune kontraktuale në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil,

në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet të përkojë me përfundimin e periudhës së provës, që në këto raste fillon në datën 26.02.2014.

- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës, për të gjithë punonjësit që e përfundojnë atë, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
  - Të administrohet në dosjen e personelit, rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), si dhe certifikata e lëshuar në këtë rast prej këtij institucioni.
  - Procesi duhet të përfundojë me vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës, për secilin nëpunës që trajtohet sipas procedurave të mësipërme.
  - Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, të përfshihet evidentimi i bazës ligjore ku mbështetet procesi, si dhe të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin, datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr.152/2013, të evidentohet në akt, numri dhe data e dokumentit të përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit, pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).
6. Njësia e burimeve njerëzore, në zbatim të nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, “*Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative*”, duhet të ndryshojë aktet e pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil, duke e plotësuar aktin me afatin kohor të pezullimit, për nëpunësit si më poshtë:
- \*\*\*\*\* , me aktin nr. 44, datë 23.09.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, është vendosur pezullimi nga shërbimi civil;
  - \*\*\*\*\* , me aktin nr. 35, datë 30.04.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, është vendosur pezullimi nga shërbimi civil.
7. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, duhet të përfundojë procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014, për ata nëpunës, për të cilët procedura ishte në proces, sipas përcaktimeve të vendimit nr.109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, sipas rekomandimeve të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.
8. Të plotësohet dosja e personelit me të gjitha dokumentet e evidentuara si në mungesë, në tabelat aneks, bashkëlidhur këtij raporti, sipas rekomandimit në raportin e mbikëqyrjes.
9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të Vendimit nr.78, datë 29.07.2015, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Kjo procedurë ka filluar me Vendimin nr.37, datë 01.04.2016, të Komisionerit, me anë të të cilit u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin e inspektuar në datën **05.04.2016** dhe i kërkoi personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, nëpunëses \*\*\*\*\*, dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikave 3 dhe 4, formati i përshkrimit të punës është bërë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe janë nënshkruar nga nëpunësi civil, eprori direkt, por jo të gjitha nga Sekretari i Përgjithshëm. Nisur nga fakti se Departamenti i Administratës Publike, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit IPA 2012 “Mbështetje për reformën e shërbimit civil në Shqipëri”, është duke i rishikuar edhe një herë përshkrimet e punës, këto pika të vendimit do të jenë objekt i verifikimit të mëvonshëm nga ana e Komisionerit.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 5, rezultoi se për nëpunësit në periudhë prove janë zbatuar detyrimet ligjore të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr.143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese”. Konkretisht, nëpunësit kanë ndjekur programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-së; kanë ndjekur udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil dhe janë vlerësuar për periudhën e provës. Në përfundim të kësaj procedure, pas mbarimit të periudhës së provës ka dalë akti i konfirmimit si nëpunës civil nga eprori direkt, mbështetur në rezultatin e testimit të trajnimit të detyrueshëm në ASPA dhe vlerësimin e rezultateve individuale në punë. Për përfundimin e periudhës së provës të të gjithë nëpunësve është njoftuar Departamenti i Administratës Publike, me shkresë zyrtare nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit European.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 6 të vendimit, njësia përgjegjëse në përputhje me nenin 128 të Kodit të Procedurës Administrative, “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative” ka zbatuar rekomandimin e Komisionerit duke nxjerrë aktin e pezullimit nr.19, datë 01.09.2015 “Për një shtesë në Vendimin nr.44, datë 23.09.2014 “Pezullim nga detyra”, për punonjësen Greta Rakaj dhe aktin e pezullimit nr.18, datë 01.09.2015 “Për një shtesë në Vendimin nr.35, datë 30.4.2014”, për punonjësin Naim Hushi.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 7 të vendimit, rezultoi se vlerësimet vjetore ishin bërë në përputhje me nenin 62 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar dhe Vendimit nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 8, rezultoi se ishte bërë verifikimi i gjendjes gjyqësore dhe ishte plotësuar dosja e personelit me aktet që mungonin (*dëshmi penaliteti dhe raporte mjekësore*). Ky dokumentacion ishte administruar në dosjen e personelit.

Sa më sipër, u verifikua reagimi i njësisë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes, u mbajt procesverbali i konstatimit dhe përfundimisht, arrij në konkluzionin se Vendimi nr. 78, datë 29.07.2015 ,“ *Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Integritimit Europian*”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Ministria e Integritimit Europian**.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Ministria e Integritimit Europian.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 78, datë 29.07.2015 ,“*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Integritimit Europian*”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Ministria e Integritimit Europian, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**